

RREGULLORE PËR PËRGJEGJËSINË DICIPLINORE DHE MIRËSJELLJEN NË QKSS

Kjo rregullore rregullon përgjegjësinë disiplinore dhe mirësjelljen për zyrtarët e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS).

1. Obligimet e zyrtarit të QKSS

1.1 Çdo zyrtar i QKSS është i obliguar që të respektojë të gjitha obligimet që dalin me Kontratë si dhe me Ligjin e Punës së Republikës së Kosovës

1.2 Kontrata në mes të QKSS dhe zyrtarit të QKSS përbënë dokumentin juridik bazë përderisa kjo rregullore mbulon përgjegjësi tjera disiplinore dhe të mirësjelljes.

1.3 Rregullorja vlen tek stafi me orar të plotë, gjysëm të plotë, praktikantët dhe stafi mysafir.

1.4 Kjo rregullore nuk suprimon të drejtat dhe obligimet që dalin me kontratën e punës si dhe me ligjet aktuale në fuqi.

1.5 Rregullorja shërben si dokument juridik suplementar. Kjo rregullore do të shërbejë si aneks i kontratës së punës.

2. Shkeljet disiplinore në QKSS

2.1 Shkeljet disiplinore konsiderohen të gjitha ato veprime që anashkalojnë detyrat dhe përgjegjësitë të listuara si më poshtë:

- a) Mosrespektimi i direktivave në kryerjen e detyrave të rregullta të QKSS
- b) Mosrespektimi i instruksioneve profesionale në hulumtimet e QKSS
- c) Deklarimi në media për temat jashtë fushëveprimit të zyrtarit të QKSS në emër të QKSS, pa autorizim paraprak
- d) Dëmtimi apo përdorimi i paautorizuar i pasurisë së QKSS
- e) Mungesa e paarsyeshme në vendin e punës, pa pëlqim paraprak
- f) Shkeljet tjera disiplinore të definuara me Ligj

3. Shkeljet e lehta

3.1 Shkeljet e lehta konsiderohen të gjitha veprimet të listuara si më poshtë:

- a) Arrdhja në punë me vonesë të paarsyetuar
- b) Marrëdhëniet jokorrekte ndaj kolegëve dhe partnerëve (p.sh fyerjet, neglizhenca, refuzimi në kryerjen e detyrave)
- c) Sjelljet e pahijshme të zyrtarit të QKSS në dëm të interesave të organizatës
- d) Shkaktimi i papastërtisë në pjesët e përbashkëta
- e) Duhan-pirja brenda hapësirave të mbyllura të zyrave të QKSS
- f) Ngrënia e ushqimeve të ngrohta brenda hapësirave të mbyllura punuese të zyrave të QKSS me përjashtim të kuzhinës apo me pajtim të partnerit në zyre.

4. Masat dicitlinore

4.1 Për shkeljet dicitlinore të listuara në Nenin 2 do të përdoren këto masa dicitlinore, sipas renditjes si më poshtë:

1. Vërejtja me shkrim
2. Kompenzimi me para (në rast se shkelja implikon dëme materiale për QKSS)

4.2 Për shkeljet e lehta të listuara në Nenin 3 do të përdoren këto masa dicitlinore, sipas renditjes si më poshtë:

1. Verejtja me gojë

4.3. Ne rast se masat e lart-cekura në pikën 4.1 nuk prodhojnë efekt atëherë çdo përsëritje e shkeleve të lartcekura në Nenin 2 të kësaj kondrate do të konsiderohet shkelje e rëndë, ku shkelësi do të ballafaqohet me masat si në vijim:

1. Ulje në pozitë;
2. Suspendim për 1 muaj pa pagesë;
3. Largim nga puna;

4.4. Ne rast se masat e lart-cekura në pikën 4.3 nuk prodhojnë efekt atëherë për çdo përsëritje të shkeleve të lartcekura në Nenin 3 të kësaj kontrate do të konsiderohet si shkelje e nenit 2 dhe për shkelësin do të aplikohen masat e parapara në pikën 4.1. të kesaj kontrate.

5. Vendimi për masat dicitlinore

5.1 Sekretari i QKSS është i autorizuar që të merr vendime për masat dicitlinore siç parashihet me Nenin 4.

5.2 Në rast paknaqësie me vendimin, zyrtari mund të ankimojë masën tek shkalla e dytë, nëpërmjet komisionit të përbërë nga Drejtori Ekzekutiv i QKSS, një pjestar tjetër i stafit të QKSS dhe një bashkëpunor i jashtëm.

5.3 Në rast paknaqësie dhe pas shterrjes së të gjitha mundësive brenda QKSS, kontesti drejtohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

6. Obligueshmëria dhe zbatimi i rregullorës

6.1 Kjo rregullore hyn në fuqi nga 1 janari 2015. Rregullorja është miratuar dhe nënshkruar nga ana e Kuvendit të QKSS në aneksin e saj.

6.2 Kjo rregullore është në pajtim me Ligjin 03/L-134 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare dhe Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës

6.3 Të gjithë zyrtarët e QKSS janë të obliguar të respektojnë këtë rregullore.
